



**RREGULLORE  
PËR TËRHEQJEN E TRENAVE NË  
HEKURUDHAT E KOSOVES TRAINKOS SH.A.**

**Fushë Kosovë**

**2025**

## Përmbajtja

<b>KUSHTET E PËRGJITHSHME</b> .....	4
Dispozitat hyrëse Neni 1 .....	4
Aktivitetet e tërheqjes së trenave Neni 2 .....	4
Vendet organizative dhe zyrtare të tërheqjes së trenave Neni 3 .....	5
Aftësia profesionale e personelit të mjeteve tërheqëse Neni 4 .....	5
<b>MJETET E TRANSPORTIT TË TËRHEQJES</b> .....	8
Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve tërheqëse Neni 9.....	8
Objektet, impiantet, pajisjet dhe materialet tjera Neni 10.....	9
<b>AKTIVITETET E TËRHEQJES</b> .....	10
Puna me ndërrime (Turnusi) Neni 11 .....	10
Orari i punës Neni 12.....	10
Posedimi i mjeteve tërheqëse Neni 13 .....	11
Përgatitja dhe dorëzimi i mjeteve tërheqëse Neni 14.....	12
Mbajtja gatishmëri (rezervat) Neni 15.....	13
Vozitja në hekurudhë Neni 16 .....	13
Dorëzimi i mjeteve tërheqëse pas përfundimit të punës Neni 17.....	13
Transportimi i mjetit tërheqës Neni 18 .....	14
Procedurat në rast dështimi të mjetit tërheqës Neni 19.....	14
Pranim-dorëzimi i mjeteve tërheqëse ndërmjet përdoruesve (Nëse ka marrëveshje mes më shumë Operatorëve të Transportit) Neni 20.....	15
Strehimi i mjeteve tërheqëse në gjendje të rregullt jashtë trafikut Neni 21 .....	15
E drejta për të drejtuar mjetin tërheqës Neni 22 .....	16
Leje për tu vozitur në mjetin tërheqës Neni 23 .....	16
A. Personat që kanë të drejtë të voziten në mjetin tërheqës.....	16
B. Leje të përhershme dhe të përkohshme për t'u vozitur në mjetin tërheqës .....	17
Rastet e jashtëzakonshme Neni 24.....	18
A. Organizimi i punës gjatë rasteve të jashtëzakonshme .....	18
B. Procedura në ngjarje të jashtëzakonshme.....	19
Masat e kujdesit kundër zjarrit Neni 25 .....	20
Hyrja në fuqi Neni 26 .....	20

Vendet e punës të cilat duhet të pajisen me këtë Rregullore:

- a) punëtorët e tërheqjes
  - makinistët,
  - ndihmës makinistët
  - mbikëqyrësit e lokomotivave,
  - inxhinierët dhe
  - teknikët e tërheqjes
- b) vendet e punës në tërheqjen e trenave,
  - shefi i njësisë -TU-TM,
  - shefi i punëtorisë së MML-së,
  - menaxheri i sektorit TU-TM,
  - instruktori shkollorë
  - organi kontrollues-pranues
  - shërbimi operativ
  - menaxher i mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse;
- c) vendet e punës shërbimi i trafikut
  - kontrollori i sigurisë së komunikacionit hekurudhorë,
  - kontrollori i kontrollës së brendshme,
  - punonjësi mbikëqyrës për shërbimin e komunikacionit,
  - drejtuesi i trenave,
  - instruktori shkollorë,

Shkurtesat:

HK – Hekurudhat e Kosovës,

KE-Kryeshefi Ekzekutiv,

ARH-Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave,

DOH– Depaertamenti i Operimeve Hekurudhore,

R.Gj - Riparimi Gjeneral,

R.M - Riparimi i Mesëm,

R.Rr – Riparimi i Rregullt

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-111 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të Nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Koorporative për NP, Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A. në Mbledhjen Nr. 30, të mbajtur më 23.12.2025, miraton këtë:

## **Rregullore për tërheqjen e trenave në Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A.**

### **PJESA I**

#### **KUSHTET E PËRGJITHSHME**

Dispozitat hyrëse

Neni 1

1. Kjo rregullore përmban dispozitat mbi bazën e të cilave rregullohet veprimtaria e tërheqjes së trenave në Hekurudhat e Kosovës.
2. Krahas këtyre dispozitave, zbatohen edhe rregullore të tjera të komunikacionit hekurudhor dhe rregullore teknike që e rregullojnë këtë fushë.
3. Me këtë rregullore duhet të pajisen makinistët dhe vendet e punës të përcaktuara në Rregullore.
4. Hekurudhat e Kosovës (HK) mund të përcaktojnë edhe vende të tjera pune dhe punëtorë që duhet të pajisen me këtë rregullore.

#### **Aktivitetet e tërheqjes së trenave**

Neni 2

1. Tërheqja e trenave në Hekurudhat e Kosovës është një nga veprimtaritë kryesore në komunikacionit hekurudhor. Kjo veprimtari ka për detyrë:
  - sigurimin në kohë të mjeteve tërheqëse të afta dhe të përshtatshme për tërheqjen dhe manovrimin e trenave;
  - sigurimin e personelit të nevojshëm dhe të kualifikuar për tërheqjen dhe manovrimin e trenave;
  - realizimin e komunikacionit hekurudhor të sigurt, të rregullt dhe ekonomik;
  - mirëmbajtjen e mjeteve tërheqëse në gjendje të rregullt teknike.
2. Për realizimin e këtyre detyrave, njësitë përkatëse të tërheqjes së trenave, nëpër vendet e përcaktuara, disponon me mjete, impiante dhe objekte të nevojshme për të garantuar korrektësinë dhe aftësinë funksionale të mjeteve tërheqëse.

## Vendet organizative dhe zyrtare të tërheqjes së trenave

### Neni 3

1. Për realizimin e veprimtarisë së tërheqjes, ekzistojnë njësi të organizuara si depot dhe punëtoritë (të quajtura më tej “njësi tërheqëse”), sipas strukturës organizative të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A.
2. Njësia tërheqëse disponon me personel të kualifikuar për tërheqje, mjete tërheqëse, objekte dhe pajisje të tjera të nevojshme për kryerjen e detyrave. Ajo gjithashtu mund të ketë në dispozicion mjete për mirëmbajtjen e mjeteve tërheqëse dhe për ndërhyrje në raste të jashtëzakonshme.
3. Pjesa e hekurudhës në të cilën njësi tërheqëse tërheq trenat quhet **seksion i tërheqjes** (ose sektor).
4. Pjesa e rrjetit hekurudhor në të cilën njësi tërheqëse realizon operacione tërheqëse quhet **zona e tërheqjes** së asaj njësie.
5. Njësia e tërheqjes kujdeset në zonën e saj për të gjitha objektet, impiantet dhe pajisjet në përgjegjësinë e saj, për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve tërheqëse, ofrimin e asistencës në raste emergjente dhe për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tërheqjes.
6. **Parku i njësisë së tërheqjes** është hapësira ku janë të vendosura objektet dhe impiantet binarët, ndërtesat etj.) që përdoren për realizimin e punëve të njësisë së tërheqjes.
7. Kufiri i sektorit është vendi në rrjetin hekurudhor ku kryhet pranim-dorëzimi i mjeteve tërheqëse ndërmjet njësisë së tërheqjes dhe stacionit. Ai përcaktohet sipas rendit të punës së stacionit dhe rregullores përkatëse të njësisë të tërheqjes.
8. **Punëtorët e shërbimit operativ të tërheqjes**, sipas kësaj rregulloreje, janë dispeçeri i vagonëve dhe mbikëqyrësi i lokomotivave.

## Aftësia profesionale e personelit të mjeteve tërheqëse

### Neni 4

1. Personeli i mjetit tërheqës përfshinë:
  - makinistin,
  - ndihmësin e makinistit.
2. Makinisti është person i kualifikuar profesionalisht për përdorimin e një ose më shumë llojeve dhe serive të mjeteve tërheqëse në linjat hekurudhore dhe stacione, përkatësisht: lokomotiva, me naftë, , dhe trena motorikë.
3. Makinistët klasifikohen si vijon:  
(Ky lloj klasifikimi bëhet vetëm nëse plotësohen kushtet)
  - **Makinist instruktur** – punëtor që i ka plotësuar kushtet për të drejtuar të gjitha llojet e trenave dhe për trajnimin e kandidatëve për makinist;
  - **Makinist i rangut të parë** – punëtor që ka të drejtë të drejtojë trena afaristë, ekspres, të shpejtë dhe të përshpejtuar;
  - **Makinist i rangut të dytë** – punëtor që drejton trena të pasagjerëve dhe trena lokalë të udhëtarëve;
  - **Makinist i rangut të tretë** – punëtor që drejton mjet tërheqës për trenat e mallrave.

#### 4. Përparimi në rang:

- **Makinist instruktur** është makinist i rangut të parë që ka dhënë provime shtesë përkatëse;
- **Makinist i rangut të parë** është ai që ka drejtuar së paku 3 vjet si makinist i rangut të dytë dhe ka përmbushur kushtet e tjera;
- **Makinist i rangut të dytë** është ai që ka drejtuar së paku 3 vjet si makinist i rangut të tretë dhe ka plotësuar kushtet përkatëse, ose ai që ka humbur gradën e makinistit të rangut të parë;
- **Makinist i rangut të tretë** është ai që ka dhënë provimin profesional dhe ka përvojë deri në 3 vjet, ose ai që ka humbur gradën e makinistit të rangut të dytë. Me ndryshimin e rangut, makinistit i lëshohet vendim përkatës.

### Neni 5

1. Personeli i mjeteve tërheqëse duhet të njohë mirë rregulloret e shërbimit të tij dhe të shërbimeve të ndërlidhura, për të kryer punën me saktësi dhe për të garantuar sigurinë e trafikut hekurudhor. Përgjegjës për këtë është menaxheri i njësisë së tërheqjes.
2. Shefi i njësisë së tërheqjes ose personi përgjegjës duhet t'ia dorëzojë personelit rregulloret dhe udhëzimet përkatëse, me konfirmim të nënshkruar dhe sipas formularit të paraparë në Rregulloren 650. Personeli është i detyruar të kujdeset për të pasur versionet më të fundit të rregulloreve, duke përfshirë ndryshime, korrigjime dhe interpretime. Për çdo ndryshim duhet të njoftohet zyrtarisht me dëshmi.
3. Personeli i mjeteve tërheqëse është i detyruar të ndjekë trajnimet sipas orarit zyrtar. Trajnimet organizohen veçmas për makinistët, dhe ndihmësit e makinistëve.
4. Nëse një punonjës nuk kalon provimin periodik, atij i ndalohej të ushtrojë punë që ndërlidhen drejtpërdrejt me sigurinë hekurudhore, derisa të dëshmojë sërish aftësinë përmes përsëritjes së provimit, sipas Rregullores mbi përgatitjen profesionale.
5. Kur personeli duhet të shërbejë në një vijë hekurudhore që nuk e njeh, fillimisht duhet të udhëtojë në mjetin tërheqës si person i tretë për t'u njohur me linjën. Vetëm pas një deklaratë me shkrim në njësinë përkatëse, ku dëshmon njohjen e plotë të vijës ditën dhe natën, ai mund të fillojë shërbimin e pavarur. Nëse vozitja bëhet në një vijë të panjohur nga makinisti, ai duhet të shoqërohet nga një punëtor i së njëjtës profesion që njeh atë vijë, në cilësinë e pilotit.

### Informimi i personelit të mjeteve tërheqëse

#### Neni 6

1. Personeli i mjeteve tërheqëse duhet të jetë i informuar me evidentim për të gjitha urdhrat dhe udhëzimet e dhëna, përkatësisht për gjithçka që duhet të dijë për kryerjen e sigurt dhe të rregullt të shërbimit. Njoftimet bëhen me shkrim në librat e njoftimeve, ku theksohen urdhrat dhe udhëzimet përkatëse. Urdhrat më të rëndësishëm duhet të shpjegohen dhe interpretohen gjatë shkollimit të rregullt, ndërsa njoftimet urgjente jepen gojarisht në fillim ose gjatë kryerjes së detyrës.

Libri i njoftimeve është dokument zyrtar, për saktësinë e të cilit njësia e tërheqjes duhet të kujdeset rreptësisht. Ekzistojnë dy lloje librash të njoftimeve:

- për njoftime dhe udhëzime të karakterit të përhershëm, dhe
- për njoftime dhe udhëzime të karakterit të përkohshëm.

Informimi i punonjësve të hekurudhës që punojnë në binarët industrialë ose kanë orar të përhershëm jashtë njësisë tërheqëse bëhet përmes pikave zyrtare si stacionet e trenit.

2. Personeli i mjeteve tërheqëse, në momentin e marrjes së detyrës, është i obliguar të kontrollojë nëse ka ndonjë njoftim të ri, të njihet me përmbajtjen e tij dhe ta konfirmojë atë me nënshkrim dhe datë. Marrja e njoftimeve kontrollohet rregullisht nga mbikëqyrësi i mjeteve tërheqëse ose personi tjetër i autorizuar.
3. Personeli që ka munguar nga detyra për një periudhë të caktuar duhet të njoftohet me të gjitha udhëzimet dhe njoftimet e dhëna gjatë mungesës.
4. Njësia e tërheqjes është përgjegjës për dhënien në kohë dhe në mënyrë të saktë të çdo njoftimi. Njoftimet urgjente jepen edhe gojarisht, ndërsa ata që ndodhen në rrugë informohen përmes stacioneve ose njësisë së tërheqjes ku gjendet personeli përkatës.

### **1. Dorëzimi dhe pranimi i njësisë tërheqëse**

#### **Neni 7**

Udhëheqësi që pranon njësinë e tërheqjes mund të fillojë detyrën vetëm pasi t'i jetë dorëzuar zyrtarisht njësia.

2. Dorëzimi dhe pranimi i detyrës gjatë ndërrimit të udhëheqësit të njësisë bëhet nga një komision, përbërja e të cilit përcaktohet nga DOH.
3. Për këtë proces hartohet një procesverbal, të cilit i bashkëngjiten rregullorja dhe udhëzimet e njësisë së tërheqjes. Shtojca e procesverbalit duhet të përmbajë të gjitha elementet e rëndësishme për realizimin e shërbimit dhe përgatitet në kohën e duhur nga drejtuesi që dorëzon detyrën.
4. Procesverbali i dorëzimit, së bashku me shtojcat, përgatitet në katër kopje:
  - një kopje për DOH,
  - një për udhëheqësin që dorëzon,
  - një për udhëheqësin që pranon.

## PJESA II

### MJETET E TRANSPORTIT TË TËRHEQJES

#### Mjetet tërheqëse Neni 8

1. Për kryerjen e shërbimeve të tërheqjes janë të nevojshme mjetet si vijon:

- mjetet tërheqëse,
- objektet, dhe pajisjet,
- materiale tjera

Mjetet tërheqëse janë mjete hekurudhore vetëlëvizëse.

2. Mjetet tërheqëse ndahen në këto kategori:

**a) Lokomotiva:**

- Lokomotiva dizell,

**b) Trena motorikë:**

- trena motorikë dizell,

**c) Mjete motorike për qëllime të veçanta.**

#### Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve tërheqëse Neni 9

1. Saktësia dhe funksionimi i sigurt i mjeteve tërheqëse sigurohen përmes mirëmbajtjes së rregullt. Për mirëmbajtjen janë përgjegjëse njësitë e mirëmbajtjes MML .
2. Çdo parregullsi apo mungesë në mjetin tërheqës, edhe nëse nuk është menjëherë e rrezikshme për funksionimin e tij, duhet të eliminohet sapo të konstatohet, me qëllim parandalimin e përkeqësimit të defekteve dhe sigurimin e funksionimit të saktë dhe ekonomik të mjetit.

Personeli i mjetit tërheqës ka për detyrë të përpiqet të eliminojë çdo parregullsi gjatë rrugës, nëse kjo është e mundur.

3. Në rastet kur parregullsitë apo dëmtimet nuk mund të riparohen menjëherë dhe mund të tolerohen përkohësisht pa rrezikuar sigurinë e funksionimit të mjetit, kjo duhet të raportohet me shkrim punonjësit përgjegjës të tërheqjes, me qëllim njoftimin e makinistit. Pas përfundimit të udhëtimit, riparimet e nevojshme duhet të kryhen pa vonesë.

4. Mirëmbajtja e disa mjeteve tërheqëse të veçanta realizohet sipas dispozitave të Rregullores për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore në Hekurudhat e Kosovës- Trainkos Sh.A.

**Objektet, impiantet, pajisjet dhe materialet tjera**  
**Neni 10**

1. Çdo njësi tërheqëse, në përputhje me llojin e mjeteve tërheqëse që përdor dhe fushëveprimin e saj, duhet të disponojë objektet, impiantet dhe pajisjet e nevojshme për të garantuar një trafik hekurudhor të sigurt, të rregullt dhe ekonomik.
2. Shpërndarja dhe ndërlidhja e objekteve, impianteve dhe pajisjeve në njësitë tërheqëse duhet të organizohet në mënyrë që të mundësohet një proces teknologjik sa më racional dhe funksional për operimin efikas të njësisë.

## PJESA III

### AKTIVITETET E TËRHEQJES

#### Puna me ndërrime (Turnusi)

##### Neni 11

1. Puna në njësitë tërheqëse të trenave organizohet me ndërrime (në vijim: turnus), në përputhje me nevojat e trafikut hekurudhor.
2. Turnusi paraqet një orar pune sipas të cilit personeli dhe mjetet tërheqëse angazhohen në ndërrime të njëpasnjëshme.
3. Turnusi i personelit të mjeteve tërheqëse përgatitet nga njësia përkatëse e tërheqjes, bazuar në detyrat që rrjedhin nga orari i lëvizjes së trenave.
4. Gjatë përpilimit të turnusit të personelit, duhet të respektohen aktet në fuqi që rregullojnë orarin e punës së punonjësve të autorizuar për përdorimin e mjeteve tërheqëse. Po ashtu, gjatë hartimit të turnusit të mjeteve tërheqëse, duhet të zbatohen treguesit teknikë dhe normat përkatëse të shfrytëzimit të tyre.
5. Turnusi i mjeteve tërheqëse duhet të hartohet në mënyrë që çdo mjet të përdoret për llojin e tërheqjes për të cilin është strukturalisht i përshtatshëm dhe ekonomikisht i qëndrueshëm.
6. Turnuset e mjeteve tërheqëse përgatiten nga njësia përkatëse e tërheqjes TU-TM.

#### Orari i punës

##### Neni 12

1. Në bazë të turnuseve të përcaktuara dhe mënyrës së disponimit të mjeteve tërheqëse, njësitë përkatëse TU-TM përgatisin orarin mujor të punës për personelin e mjeteve tërheqëse. Duke u mbështetur në këtë orar dhe sipas kërkesave ditore për mjetet tërheqëse (për trenat e jashtëzakonshëm, anulimet ose ndryshimet e trenave të rregullt), personi përgjegjës harton orarin ditor të punës.
2. Në rast se, për arsye të caktuara, turnusi i planifikuar nuk mund të zbatohet, gjatë përpilimit të orarit të punës duhet të respektohet rendi i planifikuar i angazhimit të personelit dhe mjeteve, përveç kur ekzistojnë arsye të arsyetuara për devijime.
3. Në rast të ndryshimeve ose plotësimeve në orarin e punës të publikuar, personeli i përfshirë duhet të informohet në mënyrë të përshtatshme dhe me kohë. Personeli i mjeteve tërheqëse ka për detyrë të ndjekë çdo ndryshim në orarin e punës. Nëse një punonjës, për shkak të sëmundjes apo arsyeve të tjera të ligjshme, nuk mund të paraqitet në punë, ai duhet të njoftojë njësinë përkatëse të paktën **6 orë** para fillimit të turnit.
4. Nëse njësia tërheqëse nuk është në gjendje të sigurojë në kohë mjetet tërheqëse të porositura, ajo është e obliguar të njoftojë menjëherë shërbimin e trafikut dhe, me marrëveshje të ndërsjellë, të zgjidhë çështjen e transportit.
5. Nëse një treni nuk mund të caktohet seria e mjetit të paraparë me turnus, shërbimi i trafikut duhet të njoftohet në kohën e duhur.

## **Posedimi i mjeteve tërheqëse**

### **Neni 13**

1. Në bazë të turnusit të mjeteve tërheqëse dhe rregulloreve për orarin e punës në Trainkos Sh.A., posedimi i mjeteve tërheqëse si rregull bëhet me më shumë personel, sepse mundëson shfrytëzim më të mirë të mjeteve tërheqëse, e jashtëzakonisht mund të jetë dhe me një personel (tren special etj.).
2. Personeli i mjetit tërheqës nënkupton numrin e punëtorëve që duhet pajisur mjete tërheqës, si dhe vendi nga ku do të operohet me të.

Mënyrat e posedimit mund të jenë:

a) te dizel lokomotivat:

- makinisti,
- makinisti dhe ndihmës makinisti.

b) te trenat dizel-motorik:

c-1 me një pjesë, dy pjesë ose tre pjesësh

- makinisti,

c-2 me dy njësi të lidhura, sete dy pjesësh dhe tre pjesësh, kur operohen nga një vend

- makinisti,

c-3 te tre ose më shumë një pjesësh të lidhura, setet dy pjesësh ose tre pjesësh, kur operohen nga një vend,

- makinisti (në ballë të trenit), përkatësisht dy makinistë (në ballë të trenit), c-4 te setet shumë pjesësh (trena me katër dhe pesë pjesë)
- dy makinistë (në ballë dhe në fund të trenit).

Posedimi e secilës seri të mjeteve tërheqëse është dhënë në Shtojca 1. të kësaj rregulloreje.

Për shkak të arsyeve të veta specifike, Trainkos Sh.A., mund të rrisë personelin e një mjeti tërheqës ose të disa mjeteve tërheqëse të lidhura.

3. Makinistëve të cilëve u është caktuar mjeti tërheqës, u jepen vegla dhe pajisje të duhura në gjendje të rregullt, me përshkrimin vegla dhe pajisje të mjetit tërheqës.
4. Pranim dorëzimi i mjeteve tërheqëse në mes personelit të mjeteve tërheqëse bëhet me shkrim,.
5. Gjatë qëndrimit në stacione ose vende të tjera jashtë njësisë tërheqës, kur janë në punë, mjetet tërheqëse duhet të jenë poseduara, kurse në qarkun e njësisë së tërheqjes duhet të jenë nën mbikëqyrje.

6. Posedimi i mjetit tërheqës në aspektin e komunikacionit hekurudhor është i rregulluar me Rregullorja e Komunikacionit (Rregullorja nr.2).

### **Përgatitja dhe dorëzimi i mjeteve tërheqëse**

#### **Neni 14**

1. Çdo mjet tërheqës në shfrytëzim, menjëherë pas kthimit nga vozitja, përkatësisht pas përfundimit të punës, duhet të përgatitet për vozitjen e radhës dhe të furnizohet me lëndët e nevojshme për punë (karburant, lubrifikant, ujë, rërë, etj.). Pajisja e mjetit tërheqës mund të shtyhet vetëm nëse ai tërhiqet nga shfrytëzimi për një kohë të gjatë ose nëse është i nevojshëm ndonjë riparim që nuk mund të kryhet në mjetin tërheqës të pajisur.
2. Mjeti tërheqës që vendoset në një binar të caktuar në njësinë tërheqëse ose në stacion, duhet të jetë i kyçur dhe i siguar kundër vetëlëvizjes. Nëse vendoset në një binar të pjerrët, duhet të sigurohet edhe me nënshtresa.
3. Mbikëqyrja e mjeteve tërheqëse në depo dhe stacione, kur ato janë në funksion (për mjetet me naftë kur motori-dizel është në punë, kryhet nga një punonjës që ka dhënë provimin përkatës.  
Për mjetet tërheqëse jashtë shërbimit në zonën e stacionit kujdeset drejtuesi i trenave ose një punonjës i autorizuar i stacionit; ndërsa në depo, punonjësi i caktuar Procedurat e detajuara janë përshkruar në Udhëzimi për Punën e Personelit të Mjeteve Tërheqëse.
4. Mjetet tërheqëse me naftë përgatiten për punë pasi të jenë kryer kontrollet përkatëse të gjendjes teknike, sipas rregulloreve përkatëse.
5. Mjetet tërheqëse brenda zonës së njësisë tërheqëse mund të drejtohen vetëm nga një punonjës të cilit i është besuar kjo detyrë, i cili e ka dhënë provimin për serinë përkatëse dhe është të paktën i kualifikuar si makinist për manovrim.
6. Lëvizja e mjetit tërheqës në zonën e njësisë tërheqëse përcillet, sinjalizohet dhe realizohet nga një punonjës i pajisur me pajisjet e nevojshme sinjalizuese, i cili ka dhënë provimin përkatës.
7. Lëvizja e mjetit tërheqës në stacion kryhet sipas rendit të punës së stacionit. Për të vërtetuar saktësisht kohën e dorëzimit të mjetit tërheqës në stacion ose në njësinë tërheqëse, mbahet një libër për pranim-dorëzimin e mjeteve në kufirin ndërmjet njësisë, përveç rasteve kur rendi i punës së njësisë së tërheqjes e rregullon ndryshe.
8. Nga momenti i largimit të mjetit tërheqës nga rrethi i njësisë së tërheqjes deri në kthimin e tij, personeli i mjeteve tërheqëse vepron sipas urdhrave zyrtare të personelit të trafikut të autorizuar.  
Vendimet për ndryshimin e turnusit ose për dërgimin e mjetit për kontroll apo riparim merren nga punonjësi operativ i shërbimit të tërheqjes.
9. Mjeti tërheqës, për të dalë nga njësia e tërheqjes, duhet të jetë teknikisht i aftë dhe plotësisht i gatshëm për t'u vënë në shërbim të trafikut, në kohën e caktuar, sipas kushteve lokale të përcaktuara nga njësia përkatëse. Ndalohen vendosja e posterëve, fotove ose simboleve të tjera në ose brenda mjetit tërheqës, të cilat nuk janë të parashikuara nga Trainkos.Sh.A., ose rregullore të tjera hekurudhore, përveç atyre të lejuara me ligj.
10. Në rast anulimi të ndonjë treni të rregullt, lokomotiva e është e nevojshme për të marrë një tren nga drejtimi i kundërt, njësia tërheqëse, respektivisht shërbimi operativ i tërheqjes, duhet të kontaktojë menjëherë me stacionin përkatës të nisjes apo me stacionin e fundit, si dhe me njësinë përkatëse të tërheqjes, për të rregulluar me përgjegjësi dërgimin e trenit.

## **Mbajtja gatishmëri (rezervat)**

### **Neni 15**

1. Në rast të paaftësisimit të mjetit tërheqës ose për dalje emergjente të trenit ndihmës, në njësinë e tërheqjes mjeti tërheqës dhe personeli mund të mbahen në gatishmëri për qëllimin e zëvendësimit të mjetit tërheqës të paaftësuar, përkatësisht ndërhyrje në rast të jashtëzakonshëm.

## **Vozitja në hekurudhë**

### **Neni 16**

1. Gjatë vozitjes së trenit, makinisti është i detyruar të respektojë kohën e rregullt të udhëtimit dhe të tregojë kujdes për shpejtësinë maksimale të lejuar të trenit, duke marrë parasysh objektet hekurudhore, pjerrësitë, kthesat dhe kushtet e tjera të përcaktuara në librezën e rendit të udhëtimit dhe në librat e njoftimeve.
2. Makinisti duhet, gjatë vozitjes, të vëzhgojë dhe monitorojë funksionimin dhe sjelljen e mjetit tërheqës në qarkullim. Menjëherë pas kthimit nga udhëtimi, të gjitha mangësitë e vërejtura ai duhet t'i shënojë në librin e riparimeve.
3. Koha e qëndrimit të trenit në stacione duhet të shfrytëzohet nga personeli i mjetit tërheqës për kontrollimin teknik të mjetit tërheqës.
4. Nëse gjatë udhëtimit makinisti vëren ndonjë parregullsi të trenit, ai duhet ta njoftojë kontrolluesin e vagonëve. Në rast se nuk ka kontrollues, makinisti merr vetë vendimin për veprimet e mëtejshme (siç është heqja e vagonit etj.).
5. Nëse treni, përkundër orarit të lëvizjes, qëndron në një stacion për shkak të bllokimit të trafikut, fatkeqësive natyrore apo arsyeve të tjera, për një kohë më të gjatë se 120 minuta, atëherë, me urdhër të drejtuesit të trenave, makinisti duhet të kryejë vozitjen e një treni tjetër në të njëjtin ose në një drejtim tjetër. Në rast se kjo nuk është e mundur, atëherë, me urdhër të dispeçerit, ai duhet ta tërheqë mjetin tërheqës në njësinë tërheqëse dhe t'ia dorëzojë atë mbikëqyrësit të mjeteve tërheqëse.

## **Dorëzimi i mjeteve tërheqëse pas përfundimit të punës**

### **Neni 17**

1. Kur treni arrin në stacionin e fundit të seksionit tërheqës, punonjësi përgjegjës e shpërndan lokomotivën nga treni, ndërsa punonjësi i stacionit (Shoqëruesi) e shoqëron mjetin tërheqës deri te shenja e kufirit të manovrimit ose e vendos atë në trenin e kthimit, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me rregullat e stacionit.
2. Nëse makinisti, gjatë rrugës, ka vërejtur ndonjë parregullsi në mjetin tërheqës që nuk ka mundur ta eliminojë, pas kthimit në njësinë tërheqëse ai e njofton gojarisht mbikëqyrësin e lokomotivës dhe e shënon mangësinë në librin e riparimeve.
3. Kur mjeti tërheqës arrin në njësinë tërheqëse, i bëhet kontrolli teknik. Pas kontrollit dhe eliminimit të ndonjë defekti eventual, fillon përgatitja e mjetit tërheqës për punën e radhës.

## **Transportimi i mjetit tërheqës**

### **Neni 18**

1. Transportimi i mjetit tërheqës që kthehet në njësinë tërheqëse amë, dërgohet për të marrë tren, për riparim ose për dorëzim në një njësi tjetër tërheqëse, kryhet nga shërbimi operativ i njësisë tërheqëse në marrëveshje me shërbimin e trafikut.
2. Kërkesa për transportimin e mjetit tërheqës dorëzohet me kohë nga njësia tërheqëse në stacion dhe në shërbimin operativ. Në këtë rast duhet të përcaktohet nëse mjete tërheqës do të transportohet si:
  - lokomotivë pune në shërbim të trenit, që përdoret për tërheqje;
  - lokomotivë pune jashtë shërbimit të trenit, që lëviz vetë;
  - lokomotivë pune si tren-lokomotivë;
  - lokomotivë jofunksionale që duhet të tërhiqet.
3. Mjeti tërheqës jofunksional, i të gjitha llojeve të tërheqjes, duhet të shoqërohet gjithmonë nga një punonjës i njësies tërheqëse që ka të paktën provimin e dhënë për ndihmës makinist. Te mjetet tërheqëse me naftë dhe elektrike, duhet të çkyçet tërheqja.

## **Procedurat në rast dështimi të mjetit tërheqës**

### **Neni 19**

1. Çdo dështim në mjetin tërheqës duhet të verifikohet dhe të përcaktohet shkaku i dështimit.
2. Dështimet në mjetin tërheqës gjatë vozitjes mund të jenë të një natyre të tillë që kërkojnë ndalesë të shkurtër në stacion ose në vijë të hapur. Pas eliminimit të mangësive, makinisti vazhdon vozitjen deri në stacionin përfundimtar ose në njësinë tërheqëse, ku kërkon riparimin. Nëse dështimi është i natyrës më të rëndë, makinisti është i detyruar që, brenda 10 minutash, të kontaktojë drejtuesin e trenave ose dispeçerin dhe ta informojë për mundësinë e eliminimit të tij. Me marrëveshje të ndërsjellë, merret vendimi për vazhdimin e riparimit të mjetit tërheqës ose për dërgimin e një mjeti tërheqës ndihmës.
3. Kur mjeti tërheqës bëhet i pa aftë për vozitje të mëtejshme (defekt), shërbimi operativ është i detyruar të njoftojë njësinë kompetente tërheqëse.
4. Nëse mjeti tërheqës dëmtohet në zonën e njësies tërheqëse, kjo e fundit përcakton shkakun e dëmtimit, merr masat për rikthimin në funksion të mjetit dhe e raporton rastin në DOH
5. Dështimet ose dëmtimet e rënda të mjeteve tërheqëse, që rrezikojnë sigurinë në komunikacion, përcaktohen nga një komision. Në procesverbalin e komisionit përfshihen skicat e nevojshme të mangësive apo dëmtimeve si dhe vlerësimi i dëmit të shkaktuar.
6. Mjeti tërheqës me defekt, sipas rregullit, shoqërohet nga personeli i vet. Në raste të veçanta, ai mund të shoqërohet nga makinisti i një mjeti tjetër tërheqës, për çka vendos dispeçeri i i vagonëve.

## **Pranim-dorëzimi i mjeteve tërheqëse ndërmjet përdoruesve (Nëse ka marrëveshje mes më shumë Operatorëve të Transportit)**

### **Neni 20**

1. Pranim-dorëzimi i mjeteve tërheqëse mund të ndodhë:
  - 1.1. ndërmjet sektorëve të tërheqjes brenda të njëjtit Operator Hekurudhor të Transportit DOH, në bazë të vendimit të DOH-it;
  - 1.2. ndërmjet njësisë të tërheqjes të dy Operatorëve të ndryshëm, në bazë të vendimeve të dy palëve të interesuara.
2. Pranim-dorëzimi i mjeteve tërheqëse mund të kryhet për këto qëllime:
  - 2.1. ndihmë të përkohshme, me ose pa personel të mjetit tërheqës;
  - 2.2. përdorim të përhershëm, bartje të mjeteve tërheqëse me ose pa kompensim, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve.
3. Vendimin për pranim-dorëzim e marrin me shkrim organet kompetente të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Në raste urgjente, mund të jepet urdhër telefonik ose radiolidhje, i cili më vonë duhet të konfirmohet me vendim me shkrim.
4. Pranim-dorëzimi i mjeteve tërheqëse ndërmjet përdoruesve bëhet me procesverbal, në të njëjtën mënyrë si pranim-dorëzimi i një mjeti tërheqës pa personel.
5. Mjetet tërheqëse që dorëzohen duhet të jenë në gjendje pune dhe të pastra, të pajisura me vegla pune, lëndë shtytëse dhe pajisje ndihmëse. Bashkë me mjetin tërheqës dorëzohet edhe dokumentacioni teknik përkatës.

## **Strehimi i mjeteve tërheqëse në gjendje të rregullt jashtë trafikut**

### **Neni 21**

1. Mjetet tërheqëse që nuk do të përdoren për një periudhë të caktuar kohore për kryerjen e trafikut, duhet të strehohen në gjendje të rregullt.
2. Gjatë strehimit, duhet të ndiqet parimi që përparësi për strehim kanë mjetet tërheqëse që kanë dalë nga mirëmbajtja e rregullt.
3. Mjetet tërheqëse mund të konsiderohen të përshtatshme për strehim vetëm nëse kanë përshkuar së paku 1000 km pas riparimit, ose nëse u ka skaduar periudha e garancionit.
4. Strehimi i mjeteve tërheqëse kategorizohet sipas dy arsyeve:
  - o **Arsyeja I:** mjetet tërheqëse që dalin si tepriçë për nevojat e orarit të trenave;
  - o **Arsyeja II:** mjetet tërheqëse që strehohen si rezervë operative.
5. Orari i strehimit të mjeteve tërheqëse, sipas rregullit, është:
  - o për lokomotivat dizel: në rend të parë nga R.Gj, pastaj nga R.M.
6. Mjetet tërheqëse që mbeten jashtë trafikut për më shumë se një muaj strehohen sipas **mënyrës së parë**, ndërsa ato që qëndrojnë jashtë trafikut deri në një muaj, strehohen sipas **mënyrës së dytë**.
7. Mjetet tërheqëse strehohen në njësitë tërheqëse, mundësisht në halla të mbuluara, të thata dhe të ajrosura mirë. Mbikëqyrja e tyre është përgjegjësi e njësisë tërheqëse në hapësirën e së cilës janë të strehuara mjetet.

8. Vendosja në strehim dhe heqja nga strehimi e mjeteve tërheqëse, sipas mënyrës së parë, kryhet me marrëveshje përkatëse.
9. Strehimi i mjeteve tërheqëse bëhet sipas udhëzimeve përkatëse të DOH-it.

### **E drejta për të drejtuar mjetin tërheqës**

#### **Neni 22**

1. Drejtimi i mjetit tërheqës lejohet vetëm punëtorëve që i plotësojnë kushtet për drejtimin e mjetit të caktuar tërheqës, në përputhje me dispozitat ligjore, Makinisti duhet të ketë leje me shkrim për drejtimin e mjetit të caktuar tërheqës, e cila shërben për identifikim. Leja me shkrim për drejtimin e mjetit tërheqës jepet në formularin dhe sipas procedurës së përshkruar nga ARH-ja.
2. Në raste jashtëzakonisht urgjente, drejtimin e mjetit tërheqës mund ta marrë përsipër edhe një person që ka të drejtë për ta drejtuar atë mjet dhe që i plotëson të gjitha kushtet e tjera për punën e makinistit. Në këtë rast, ky person merr përsipër të gjithë përgjegjësinë e makinistit nga vendi i marrjes së detyrës deri në përfundimin e vozitjes. Para fillimit të vozitjes, ai duhet të shënojë në fletën e udhëtimit vendin zyrtar ose kilometrin përkatës në vijën e hapur nga ku e ka marrë drejtimin e mjetit tërheqës. Rast urgjent, sipas kësaj pike, konsiderohet vetëm paaftësia e makinistit për të vazhduar kryerjen e detyrës.
3. Kandidatët për makinist mund të drejtojnë një mjet tërheqës vetëm nën mbikëqyrjen e makinistit. Për të gjitha parregullsitë përgjegjësia bie mbi makinistin.

### **Leje për tu vozitur në mjetin tërheqës**

#### **Neni 23**

#### **A. Personat që kanë të drejtë të voziten në mjetin tërheqës**

1. Me **vojitje në mjetin tërheqës** nënkuptohet udhëtimi në kabinën e mjetit tërheqës.
2. Gjatë vozitjes në mjetin tërheqës, përveç ekuipazhit të tij, mund të jenë të pranishëm edhe:
  - personeli i mjetit tërheqës që udhëton jashtë shërbimit me **ET.1 të vulosur**,
  - punëtorët që kanë leje të përcaktuar për t'u vozitur në një mjet tërheqës, dhe
  - personat e tjerë të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.
3. Personat e tjerë që mund të voziten në mjetin tërheqës pa leje të përcaktuar janë:
  - punëtorët e stacionit hekurudhor gjatë detyrës, manovrimeve ose ofrimit të ndihmës,
  - personeli i trenit që duhet të udhëtojë për të marrë një tren dhe nuk ka mundësi tjetër udhëtimi,
  - personeli i mirëmbajtjes së vijës hekurudhore kur udhëton urgjentisht për eliminimin e pasojave të një ngjarjeje të jashtëzakonshme dhe nuk ka mjet tjetër transporti,
  - personeli i rrjetit kontaktues gjatë kontrollit të gjendjes së rrjetit të kontaktit,
  - personeli i objekteve sinjalo-siguruese (ss) gjatë testimit të sinjalit për korrektësi në vijën hekurudhore,

- organet e MPB-së dhe mjeku për punë urgjente zyrtare, në rastet kur nuk kanë mjet tjetër transporti,
  - personeli profesional gjatë vozitjes provuese të mjetit tërheqës, testimi të materialit shtytës dhe testeve të tjera,
  - komisioni për ekzaminimin e mjetit tërheqës,
  - komisioni për dhënien e provimeve profesionale,
  - komisioni për hetimin e rasteve të jashtëzakonshme,
  - personat nën mbikëqyrje.
4. Në kabinën e mjetit tërheqës, përveç stafit, mund të voziten më së shumti edhe dy persona. Përrjashtimisht, mund të jenë të pranishëm më shumë persona, por ata duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të mos pengojnë punën e ekuipazhit të mjetit tërheqës. **Bisedat joformale me ekuipazhin janë të ndaluara.**
  5. Personat që përdorin mjetin tërheqës për t'u transportuar, pavarësisht nëse kanë ose jo leje të përcaktuar (sipas pikës 3), janë të detyruar që të identifikohen tek makinisti, edhe pa kërkesën e tij.
  6. Të gjithë personat që udhetojnë në mjetin tërheqës duhet të shënohen me emër nga udhëheqësi i trenit, përkatësisht makinisti, në fletudhëtimin e trenit ose në dokument tjetër udhëtimi të përcaktuar nga Trainkos Sh.A., H.K.

## **B. Leje të përhershme dhe të përkohshme për t'u vozitur në mjetin tërheqës**

1. Leja për t'u vozitur në mjetin tërheqës lëshohet në formë të përkohshme ose e përhershme.
  - Lejet e përhershme janë të vlefshme për një periudhë të caktuar, më së shumti një vit. Pas skadimit, leja duhet të rinovohet ose të zëvendësohet. Rinovimi ose zëvendësimi kryhet nga autoriteti kompetent për lëshimin e saj.
  - Lejet e përhershme lëshohen "**në emër**" dhe mund të përdoren vetëm nga personi për të cilin janë lëshuar. Lejet "**për bartësin**" mund të përdoren nga punëtori që ka urdhër zyrtar udhëtimi, ku tregohet numri përkatës i lejes.
  - Leja e përkohshme lëshohet vetëm "**në emër**", rast pas rasti, dhe është e vlefshme për udhëtimin me mjetin tërheqës në vijat dhe trenat e specifikuar në leje. Lëshohet gjithmonë me shkrim.
2. Lejet për udhëtim në mjet tërheqës ("**në emër**", "**për bartësin**" dhe të përkohshme) lëshohen nga:
3. Trainkos Sh.A.
4. Leje të përkohshme për udhëtim në mjet tërheqës mund t'u lëshohen edhe personave që **nuk janë** punonjës të Trainkos Sh.A.
5. Formularët (lejet për vozitje) trajtohen nga personi i caktuar i kompanisë përgjegjëse për lëshimin e tyre. Ky person mban evidencë të saktë për lejet e lëshuara. Lejet e lëshuara "**për bartësin**" trajtohen nga punonjësi i njësisë përkatëse. Edhe për këto mbahet evidencë e veçantë.

6. Dhënia e lejes për udhëtim në mjet tërheqës duhet të kryhet në atë mënyrë që të përfitojnë vetëm ata persona që janë **drejtpërdrejt të lidhur me realizimin e detyrave konkrete**, duke përdorur mjetin tërheqës.

## Neni 24

### Rastet e jashtëzakonshme

#### A. Organizimi i punës gjatë rasteve të jashtëzakonshme

1. Njësia tërheqëse e ngarkuar për të ndërhyrë në raste të jashtëzakonshme duhet të posedojë mjete të përshtatshme, pajisje dhe personel të trajnuar.
2. Mjetet për ndërhyrje në raste të jashtëzakonshme janë:
  - a) treni ndihmës dhe
  - b) pajisjet për pastrimin e borës.

#### a) Treni ndihmës

Treni ndihmës duhet të jetë i pajisur me:

- vegla, aksesorë dhe mjete të nevojshme për ngritjen e mjeteve të rrëshqitura nga binari dhe për përgatitjen e tyre për largim nga vendi i ngjarjes,
- pajisjet më të nevojshme për shpëtimin e personave të lënduar,
- pajisje për pushim dhe produkte ushqimore për punonjësit e trenit ndihmës.

Treni ndihmës zakonisht përbëhet nga disa vagonë, përfshirë: vagon për vegla, vagon për shpëtim, vagon ambulancë etj. Përbërja e trenit ndihmës përcaktohet nga Trainkos Sh.A. Trainkos duhet të ketë në dispozicion një tren ndihmës të përshtatur me rëndësinë e zonës ku vepron.

Për ndërhyrje, Trainkos ka në dispozicion edhe vinça, të cilët janë të vendosur në njësitë e mirëmbajtjes MML.

Në rast të një ngjarjeje të jashtëzakonshme të madhe, kur njësia e caktuar nuk mund të përballojë e vetme situatën, drejtuesi i trenit ndihmës kërkon ndihmë shërbime të tjera kompetente,

Për çdo tren ndihmës mbahet **libri i punës**, në të cilin drejtuesi teknik regjistron çdo dalje, punët e kryera dhe konsumin e materialeve dhe fuqisë punëtore.

**Ndalohet rreptësisht** marrja e mjeteve ose pajisjeve nga treni ndihmës për punë të zakonshme pa lejen e posaçme të drejtuesit të njësisë tërheqëse. Gjatë përdorimit të përkohshëm, pajisja duhet të kthehet menjëherë në vendin e caktuar.

Rangu, pajisjet dhe zonat e veprimit të trenit ndihmës përcaktohen nga:

## b) Pajisjet për pastrimin e borës

Pajisjet për pastrimin e borës përfshijnë:

- plugje bore,
- pastrues bore (përmenda), dhe
- larues (plugje kryqëzore) dëbore.

Plugjet për borë janë pjesë e inventarit të nevojshëm të çdo njësie tërheqëse, dhe duhet të mirëmbahen dhe ruhen në vende të përshtatshme për t'u montuar lehtësisht në rast nevojë.

Pastruesit e borës janë mjete hekurudhore pa vetëlëvizje, të cilat shtyhen nga lokomotiva për të larguar borën nga binari. Ato mund të kenë mekanizma për zgjerimin e krahëve për të ndryshuar profilin e pastrimit.

Laruesit e dëborës janë makina vetëlëvizëse që përdorin një rrotë rrotulluese për të pastruar borën. Ato mund të funksionojnë edhe të pavarura ose të shtyhen nga një lokomotivë. Disa janë të njohura si **lokomotiva me plugje kryqëzore**, që përdoren për parandalimin e grumbullimit të borës në binarë.

Pastruesit e borës dhe laruesit (plugje kryqëzore) duhet të kontrollohen çdo vit para fillimit të dimrit. Riparimet dhe kontrollet kryhen gjatë verës dhe regjistrohen sipas procedurës së zakonshme për lokomotivat.

Përdorimi i tyre rregullohet nga dispozitat **Rregullores së Komunikacionit (Rregullore nr. 2)**.

3. Për ndërhyrje në ngjarje të jashtëzakonshme, njësia tërheqëse duhet të ketë një numër të caktuar punëtorësh të trajnuar për këtë qëllim.

Në varësi të rëndësisë së zonës, DOH-i vendos formimin e një grupi të përhershëm për trenin ndihmës ose mban listën e punonjësve të përshtatshëm për thirrje të menjëhershme.

Bazuar në këtë listë, menaxheri i njësisë përgatit turnet javore, duke caktuar se cilët punëtorë mund të thirren në ditë të caktuara. Jashtë orarit të punës, punëtorët kujdestarë duhet të qëndrojnë në banesat e tyre për t'u përgjigjur menjëherë.

## B. Procedura në ngjarje të jashtëzakonshme

1. Duke marrë parasysh që ekzistojnë dy lloje mjetesh për ndërhyrje (treni ndihmës dhe mjetet për pastrimin e borës), për secilin zbatohen procedura të veçanta.
2. Sapo të merret kërkesa për tren ndihmës, njësia tërheqëse është e detyruar ta vërë atë menjëherë në dispozicion për nisje, Lokomotiva sigurohet në bashkëpunim me shërbimin operativ.
3. Mënyra e kërkesës për ndërhyrje, nisja dhe lëvizja drejt vendit të ndërhyrjes rregullohen me **Rregulloren e Komunikacionit (Rregullore nr. 2)** dhe udhëzimet përkatëse të DOH-it.

4. Detyrat kryesore të trenit ndihmës pas mbërritjes janë:
- shpëtimi i personave të rrezikuar,
  - rivendosja e trafikut sa më shpejt të jetë e mundur,
  - pastrimi i vendit të ngjarjes nga mjetet apo pjesët e tyre, si dhe pasojat e tjera. Të gjitha veprimet duhet të kryhen me sa më pak dëme.
5. Punimet në vendin e ndërhyrjes për pastrimin e borës parandalimin e bllokimit dhe menaxhimin e dëborës drejtohen nga punonjësi profesional i njësisë përkatëse.

#### **Neni 25**

#### **Masat e kujdesit kundër zjarrit**

1. Masat e kujdesit kundër zjarrit, si dhe procedurat në rast zjarri, janë të përcaktuara me Rregulloret dhe ligjet në fuqi
2. Mjetet tërheqëse dizell duhet të pajisen me numër të përshtatshëm aparatesh manuale për shuarjen e zjarrit. Makinisti i mjetit tërheqës është i detyruar të kryejë kontrollin dhe të veprojë në përputhje me këtë rregullore.

#### **Neni 26**

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin nga Bordi i Drejtorëve Trainkos Sh.A.

**Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A.**



**Jetmir Nuka**

